

Shtyhet thirrja për aplikime për bursa për studentët në kuadër të programit Erasmus + në Universitetin e Latvias, Letoni për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

Në kuadër të Programit Erasmus + është shtyrë thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit të Tiranës, në Universitetin e Latvias, Letoni për semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

-Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- Master;

Kohëzgjatja e bursave:

- Master (5 muaj);

Fushat e studimit:

- Ekonomiks;
- Administrim biznesi;

Për t'u njohur me katalogun e programeve të studimit të ofruara nga Universiteti i Latvias klikoni në adresën:

<https://www.lu.lv/en/admission/study-programmes/>

Bursat përfshijnë:

-Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
-Kostot e udhëtimit (275 Euro)

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit Master:

- CV (në gjuhën angleze);
-Kopje e Pasaportës;
-Vërtetim studenti në programin master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në anglisht);

- Diploma e Bachelor;
- Listë notash e programit bachelor (e përkthyer në mënyrë zyrtare në anglisht);
- Listë notash e programit master (e përkthyer në mënyrë zyrtare në anglisht);
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Certifikatë e gjuhës së huaj (niveli B2);
- *Dokumenti Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillojnë në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before Mobility”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës ndërsa në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Latvias lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e dytë në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillojnë në fakultetin tuaj semestrin e dytë, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvillojnë/frekuentoni lëndët që nuk përshkruhen në Universitetin e Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset fillimisht nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel fakulteti dhe më pas në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +. Nëse studenti bën ndryshime të lëndëve gjatë mobilitetit, pjesa During mobility duhet të firmoset nga personi përgjegjës në fakultet dhe më pas nga personi përgjegjës në Rektorat.

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:

http://www.unitir.edu.al/images/Learning_agreement_for_studies_Erasmus_outgoing.docx

Afati për aplikim: 20 Nëntor 2019

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë nga e Hëna në të Enjte ora 10:30 – 11:30 dhe 14:30 – 16:00, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al.

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!